



Prishtine, data: 16.03.2021

**KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE** - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 4385 dt. 12.11.2015 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **“Burimi” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80267932 me adresë; Arbanë, Prizren,, merr këtë vendim :

### AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtrësive për **“Burimi” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80267932 me adresë; Arbanë, Prizren, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

### Arsyetim

Ndaj **“Burimi” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80267932 me adresë; Arbanë, Prizren ka leshuar aktin administrativ me nr. 4385 dt. 12.11.2015 .

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 11.09.2017 dhe me dt. 06.07.2018 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .

Ramiz Krasniqi  
Drejtor  
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
Independent Commission for Mines and Minerals



Në pajtim me nenin 79 paragrafët 4 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerrë këtë:

### AKTVENDIM

Ndaj kompanisë "Burimi" Sh.p.k me nr.të biznesit 80267932 me pronar Besnik Krasniqi, me nr.personal 1016539461, me nr. të telefonit 044/128 123, me adresë; Arbanë, Prizren.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoha administrative për zhvillimin e aktivitetit ilegal pa posedimin e Lejes për Aktivitete të Veçanta - Seperacion në shumë prej 5,000.00 € (Pesë mijë euro).
2. Pala ka 15 ditë afat nga dita e miratimit të këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 1 të dispozitivit në këtë xhirrollogari 1000430070005950.

### Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 12.10.2015, kompania "Burimi" Sh.p.k është hasur duke operuar ilegalisht në përpunimin e resurseve minerare dhe kryerjen e aktivitetit ilegal pa posedimin e Lejes për Aktivitete të Veçanta - Seperacion në lokacionin e Arbanës, Prizren. Gjatë inspektimit inspektorët e minierave kanë konstatuar se kompania operon në mënyrë ilegale në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale si dhe Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, si dhe është përkufizuar lokacioni me koordinata ku kompania juaj ishte duke ushtruar aktivitetet të paligjshëm.

Kompania është udhëruar me anë të urdhërësës për ndërprerje të aktivitetit ilegal të leshuar nga inspektorët në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e paligjshëm.

Makineria dhe pajisjet që janë hasur në lokacionin e Seperacionit janë:

- Seperacioni i rërës dhe zhavorrit
- Lugë ngarkuese e tipit Libher 564.

4385

12.11.2015

Ko: Armand Daci, Nr.1  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (38) 248 252  
Fax: +381 (38) 248 844  
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org  
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

Inspektoret e KPMM kanë konstatuar se kompania juaj me pronar Besnik Krasniqi aktivitetin e operimeve ilegale e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata: Y= 7474957, 7474944, 7474908, 7474919; X= 4678121, 4678136, 4678118, 4678099; Z= 395, 396, 393, 393, për të cilat koordinata nuk keni poseduar Leje për Aktivitete të Veçanta – Seperacion të lëshuar nga organi kompetent KPMM.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM-së.

Sipas nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Administrative, ankimi administrativ nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit, sepse aktvendimi synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së,  
Departamentit të Financave të KPMM-së,  
Palës.

